

V E N D I M
Nr.233, datë 10. 4.1998

PËR ZBATIMIN E LIGJIT “PËR STATUSIN E JETIMIT”

Në zbatim të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Statusi i jetimit jepet nga Administrata e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale.
2. Për dhënien e statusit të jetimit, në Administratën e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale ngrihet një komision specialistësh në nivel drejtorie, në përbërje të të cilit të jetë edhe një përfaqësues i Shoqatës së Jetimëve të Shqipërisë. Kryetari i këtij komisioni është Drejtor i Përgjithshëm i Administratës së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale.
3. Statusi i jetimit jepet në bazë të dokumentacionit që vërteton kriteret e vendosura në nenin 1 të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”.
4. Jetimët pretendues për të fituar statusin e jetimit duhet të dorëzojnë në seksionin përkatës të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore këto dokumente:
 - a) certifikatën e lindjes së personit;
 - b) dokumentin që vërteton trajtimin e tyre nga institucionet publike ose private të përkujdesit shoqëror (shtëpitë e foshnjës dhe fëmijës), nëse janë të sistemuar në këto institucione;
 - c) certifikatën e vdekjes të të dy prindërve, nëse asnjëri prej tyre nuk është gjallë;
 - d) vendimin e gjykatës të formës së prerë, për rastin e heqjes të së drejtës prindërore të të dy prindërve ose të njërit prind, kur prindi tjetër nuk jeton;
 - e) vendimin e gjykatës që e deklaron të braktisur fëmijën nga të dy prindërit ose nga njëri prind, kur prindi tjetër nuk jeton.Për rastet e përcaktuara në shkronjën “d” dhe “e” duhet të dorëzohet edhe certifikata e vdekjes për prindin që nuk jeton.
5. Personat jetimë, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 1 të ligjit nr.8135 “Për statusin e jetimit” dhe kanë kaluar moshën 25 vjeç, përveç dokumenteve të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, për të përfituar statusin e jetimit, duhet të jenë përfitues të ndihmës ekonomike dhe të jenë të pastrehë sipas përcaktimit të bërë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.49, datë 29.1.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”. Kur vërtetohet ndryshimi i situatës ekonomike dhe të strehimit të personit jetim, ai nuk përfiton më nga statusi i jetimit.
6. Komisioni, për dhënien e statusit të jetimit, shqyrton dhe merr vendim lidhur me dhënien e statusit të jetimit sipas listës së paraqitur nga administratat rajonale të shërbimeve sociale, pasi këto të fundit të kenë verifikuar listat e paraqitura nga seksionet e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në bashki e komuna.
7. Jetimët përfitues të statusit të jetimit, që mbarojnë shkollat e mesme e të larta, jetojnë në konvikte dhe janë pa asnjë të ardhur, trajtohen me ndihmë ekonomike, duke u konsideruar si kryefamiljarë (në masën 95% të nivelit bazë të pagesës së papunësisë) në seksionet përkatëse të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore deri në zënien e tyre me punë.
8. Jetimëve që përfitojnë statusin e jetimit, gjatë periudhës së kryerjes së shërbimit të detyruar ushtarak u jepet një kuotë suplementare nga Ministria e Mbrojtjes në masën 1000 lekë në muaj.

9. Administrata e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, në bashkëpunim me Shoqatën e Jetimëve të Shqipërisë, përgatisin modelin e librezës së jetimit, e cila miratohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas. Libreza lëshohet nga Administrata e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale.

10. Efektet financiare për trajtimin me kuotë suplementare të ushtarëve jetimë gjatë kohës së kryerjes së shërbimit të detyruar ushtarak përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

11. Për çdo shpërdorim në favoret dhe lehtësitë që përfitohen nga ligji “Për statusin e jetimit”, personit përgjegjës i merret libreza e jetimit për një vit dhe, kur është rasti, organi që e konstaton shkeljen, bën kallëzim për ndjekje penale.

12. Ngarkohen ministritë përkatëse të nxjerrin udhëzimet e nevojshme në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano